# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 03.06.2024 | Kerkoj informacion ne lidhje me vendimi nr. 504, datë 30.03.2017.<br>1. Mbi ç'bazë ligjore dhe çfarë argumenti, u mor vendimi nr. 504, datë 30.03.2017 për "Për trajtimin e pronës, njohjen dhe kompensimin e saj" nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.<br>2. Pse u rrezua kjo kerkese? 3.Vënien në dispozicion vendimit bashkë me argumentet përkatëse te rrezimit te kerkeses! | 26.06.2024 | Agjencia e Trajtimit të Pronave ushtron aktivitetin e saj në zbatim të dispozitave të ligjit 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij si : VKM nr. 222, datë 23.03.2016, "Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës", i ndryshuar, dhe VKM Nr. 223, datë 23.3.2016 " Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit | E pjesshme | Jo |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigjia jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Për rastin në fjalë a ka shqyrtuar Agjencia e Trajtimit të Pronavë kërkesë tjetër nga trashgimtarët dhe përfituesit e sipërfaqes prej prej 22,4 ha të ndodhur në fshatin Vuno Vlorë. Nese po cili është vendimi i marrë?<br><br>5. A i është kthyer trashëgimtarëve sipërfaqja prej 22,4 ha ndodhur në fshatin Vuno Vlorë?<br><br>6. Sa është numri i kërkesave nga qytetaret e Bashkise Himare, të shqyrtuara nga Institucioni juaj dhe për sa kërkesa ka patur vendim për kthim të pronës? | | financiar e fizik për kompensimin e pronave", i ndryshuar.<br><br>Nga hyrja në fuqi e ligjit nr 133/2015 deri më sot e gjithë vendimmarrja për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie, apo për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare me të drejtë kompensimi të vlerësuar financiarisht, është kryer në zbatim të dispozitave të përcaktuar në aktet e sipërcituara.<br><br>Sa më sipër, në arkivën e ATP-së, rezulton se ndodhet e depozituar dosja nr. 163 e vitit 2017, e cila përmban Vendimin nr. 504, datë 30.03.2017.<br>Gjithashtu ju informojmë se referuar nenit 12 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndyshuar, si dhe *sipas Ligjit Nr.9154, date 06.11.2003 "Per Arkivat", ne Nenin 64 është përcaktuar:* "*Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe institucioneve shtetërore, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgiminë e pronave".* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Në këto kushte, ju bëjmë me dije se për të bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar si dhe vënien në dispozicion të kopjes së vendimit të sipërcituar, në mbështetje të Neneve 44, 45, 65 te Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" të Republikës së Shipërisë, nga ana juaj duhet që kërkesa të jetë e shoqëruar sipas rastit* ***me prokurë përfaqësimi, dëshmi trashëgimie, si dhe cdo dokument tjeter të nevojshëm për të provuar interesin tuaj të ligjshëm në cilësinë e personit të interesuar në këte kërkim, i cili duhet të jetë origjinal ose i njëhsuar me originalin.*** | | |